Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-124
Datë 30.07.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 17.07.2018 nxjerr këtë:

V E N D I M

Riakreditohet INFINIT Qatar Training Center, në Prishtinë me adresë Rruga Abdyl Frashëri nr. 24, për periudhën 17.07.2018 deri 17.07.2023 me:

1.1. Gjuhë angleze.

Rikreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Të sigurohen dëshmi të politikës mbi zhvillimin profesional të shkathtësive të mësimdhënies i cili mbështetet në udhërrëfyesin e AKK-së si dhe të sistemeve efektive për implementimin e kësaj politike.
- Të sigurohen dëshmi të politikave dhe procedurave për vlerësimin dhe përfshirjen në mësim të studentëve me nevoja të veçanta.
- Të rishikohet pyetësori i vlerësimit për student.
- Nxënësve dhe stafit duhet t'u bëhet e ditur procedura mbi evakuimin në rast të zjarrit.
- Certifikata e përfundimit të nivelit duhet t'u referohet kompetencave gjuhësore të kandidatit të përshkruara sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (KPERGJ).

(Afati kohor: 30. 11. 2018)

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raportin e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi i dërgohet:

- INFINIT Qatar Training Center; dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa